



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/01-16131 dt. 13.04.2022

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës të Drenasit z.Milaim Hajdari, me dt. 20.04.2022 (e mërkurë) duke filluar në ora 10:00, në sallën e Bordit të Drejtorëve të Komunës.

THËRRET
Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja do të këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur me dt. 17.03.2022.
2. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit 12 nr. 462/01-47368 të datës 30.10.2020, të Kuvendit të Komunës së Drenasit.
3. Propozim-vendim për shpronësimin e njësive të ndërtesave-banesave, në parcelën nr. 743-30, në zonën kadastrale në Glllogoc.
4. Propozim-vendim për këmbimin e pjesëve të njësive kadastrale nr.538/0 dhe 512/0 në zonën kadastrale në Nekoc.
5. Propozim-vendim për caktimin e lokacionit për zbatimin e Aktgjykimit C nr. 97/86, të dt. 06.10.1988.
6. Propozim-vendim për bartjen e të hyrave vetanake.
7. Propozim-vendim për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës nr. 02-020/04-8424, të dt. 23.02.2022.
8. Propozim-vendim për revidimin e Planit Komunal të menaxhimit të mbeturinave për vitin 2022, i plotësuar.
9. Raporti Financiar Janar-Mars 2022.
10. Të ndryshme.

Drenas, 13.04.2022



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-12890 dt. 22.03 . 2022

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 17.03.2022, ora 10:00.

Mbledhjen ë kryesoi: Milaim Hajdari- Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, si dhe drejtor të drejtorive komunale. Mungoj Malsore Cakiqi.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur me dt. 16.02.2022
2. Raporti i punës Janar-Dhjetor 2021 i Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale.
3. Raporti i dytë periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2020.
4. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në kategorinë për mallërat dhe shërbimet në buxhetin e drejtoratit për shërbimet publike dhe emergjente për projektet: mirëmbajtja e kanalizimeve fekale, atmosferike dhe gropave septike dhe rehabilitimi i rrugëve të asfaltuara.
5. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës, pati dhe një pikë shtesë për rendin e ditës. **1. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në kategorinë për Mallra dhe shërbime në buxhetin e drejtorisë për infrastrukturë publike.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës me këtë pikë shtesë të cekur me lartë, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan në mënyrë unanime.

Drejtori i Financave, Shyqeri Bublaku- gjatë hartimit të buxhetit për investime kapitale të vitit 2022 është kërkuar nga niveli qendror që të bëhen projektet ekzekutuese, drejtorit në fjalë nuk kanë arrit me i perfundu ato në detale siç po i kërkojmë pastaj kanë mbet në pjesë rezervë të buxhetit, drejtoritë kanë marrë masa që këto mjete me i qit prapë në buxhet dhe të vazhdojmë me procedura në projektet e cekura, rezervat janë buxhet i vitit 2022.

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me:
06 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 16.02.2022.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me:
06 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Raporti i punës Janar-Dhjetor 2021 i Kryetarit dhe Qeverisjes Lokale.**

Arbër Halilaj- Raporti i punës në çdo institucion do të duhej të bazohet në planin vjetor të punës, realizimin e tij me saktë në objektivat e këtij plani dhe të shpreh përqindjen e realizimit të tyre, pengesat për mosrealizim dhe hapat për përmirësim. Ka raporte të përpiluara mirë, raporti buxhetor duhet të analizuar edhe me hollësisht kështu që vërejte tjera të caktuara do t'i paraqes në seance.

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me:
06 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati, dhe e rekomanduan si pikë të rendit të ditës për mbledhjen e Kuvendit Komunal.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Raporti i dytë periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2020.**

Arbër Halilaj- menaxhimin dhe matjen e performances e shtyn para obligimin për llogaridhënie dhe transparencë ekzekutivitet, ndaj kërkesave të qytetarëve pritshmërive të tyre dhe shërbimet që atyre ju ofrohen. Vetëm për me i cek elementet e menaxhimit të performances janë planifikimi i performances, matja dhe monitorimi, vlerësimi i performances, raportimi i asaj performance dhe në fund auditimi dhe rishikimi i

performances. Siç e dimë zyra kombëtare e auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performances dhe për punën e vet i jep llogari kuvendit të Kosovës, raportet e zyrës kombëtare të auditimit promovojnë drejt për drejt llogaridhënien që e konsideroj të domosdoshme në punën e çdo komune, pasi që përmes këtij raporti mund t'i kërkojmë llogari çdo organizate buxhetore, kjo pastaj ndikon në rritjen e besimit të qytetareve në shpenzimin e duhur dhe korrekt të buxhetit që rrjedhimisht e rrit besimin në qeverisjen lokale, nisur nga kjo auditimi është element shumë i rëndësishëm në procesin e rëndësishëm në procesin e vlerësimit të performances kur të gjeturat dhe rekomandimet nga auditimet atyre do t'ju jepet prioritet i lartë nga fakti që vijnë nga një trup e pa varur profesionale e kontrollit të jashtëm të performances të komunës, krejt qëllimi i gjithë këtij procesi përmirësimi i performances dhe përmbushja e pritshmërisë të përmbushjes të qytetareve.

Florentina Elezi-Veliu, njeri nga rekomandimet që nuk është zbatuar është edhe mungesa e projekteve dmth i keni pas 24 kontrata pa projekte, ju keni thënë që operatori ekonomik është jo funksional, mirëpo a keni bërë diçka për me e evitua këtë për vitet në vazhdim.

Drejtori i Financave, Shyqeri Bublaku- sa i përket kësaj me herët e ceka që raportet ekzekutuese të projekteve kapitale kemi pas një kontratë me një operator ekonomik i cili nuk i ka përmbush kriteret dhe i kemi ndërpre kantatën me ata, dhe për këtë arsye kemi pas vështirësi në implementimin në disa projekte. Dhe ne vazhdim dha një sqarim lidhur me këtë pikë të rendit të ditës

Pasi këtyre diskutimeve, vërejtje dhe sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me:

06 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati, dhe e rekomanduan si pikë të rendit të ditës për mbledhjen e Kuvendit Komunal.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në kategorinë për mallërat dhe shërbimet në buxhetin e drejtoratit për shërbimet publike dhe emergjente për projektet: mirëmbajtja e kanalizimeve fekale, atmosferike dhe gropave septike dhe rehabilitimi i rrugëve të asfaltuara.**

Drejtoresha për Shërbime Publike dhe emergjente-Lumnije Krapi, ne e kemi pas te planifikuar me buxhet, dhe i kemi pas kontratat e nënshkruara, paraprakisht ministria e financave u dashtë me herët me na njoftu ata meqenëse i kane kaluar ne rezerva buxhetore andaj ne kemi obligim ndaj operatorit sepse i kemi kontratat e nënshkruara, gjithsesi ne e kalojmë prapë në kuvend dhe i kalojmë në kodet ku na nevojiten projektin mirëmbajtja e kanalizimit dhe renovimi i gropave të asfaltuara.

Hamit Haxhiu, a e parasheh ligji i financave ridestinimin e mjeteve nga një kategori në tjetrën?

Drejtori i Financave, Shyqeri Bublaku- ligji i financave e lejon deri ne 5 % të shumës të drejtorisë programit apo nen programit lejon me u bartë të shumës totale të buxhetit.

Hamit Haxhiu, kërkoj që të ceken rrugët segmenti rrugës çfarë periudhe është përfundu ajo rrugë të dina se për çka është fjala ma saktë, sepse ka rrugë që është shtruar ma herët dhe ne nuk jemi ne dijeni.

Drejtoresha për Shërbime Publike dhe emergjente-Lumnije Krap, Projekti është për të gjitha rrugët e Komunës të Drenasit, për rinovim të atyre rrugëve, ndërsa mirëmbajtja e kanalizimeve është mirëmbajtja e kanalizimeve fekale kur bllokohen kanalizimet ose kur ka të reshura atmosferike që mbyllen.

Pasi këtyre diskutimeve, vërejtje dhe sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me:
06 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati, dhe e rekomanduan si pikë të rendit të ditës për mbledhjen e Kuvendit Komunal.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim vendim për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në kategorinë për Mallra dhe shërbime në buxhetin e drejtorisë për infrastrukturë publike.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar dhe votuan me:
06 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati, dhe e rekomanduan si pikë të rendit të ditës për mbledhjen e Kuvendit Komunal.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës. **6. Të ndryshme.**

Hamit Haxhiu, organizata "For New Live Kosovo" ka bërë një kërkesë para një muaji që ta ketë një buxhet për një ekspozitë në Turqi, Kumrije Prenku ka bërë kërkesë të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport që ta ketë një mbulesë të buxhetit për Turqi për një ekspozitë, shfaqje për masakra të Drenicës, kërkoj një sqarim nga drejtoresha pse mos me ju rimbushersu një pagesë kur është qytetareve për të mirën e familjareve, kostoja është afër 3.000 €. Kërkoj një sqarim.

Drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport Laureta Thaqi, lidhur me pyetjen organizata "For New Live Kosovo" ka bërë kërkesë përmes protokollit, ku ka marrë përgjigje, ka kërkuar mbështetje financiare për realizimin e një ekspozite në Stamboll përkatësisht heqjen e shpenzimeve të rrugës dhe qëndrimit atje, kush më shumë së sa unë që vij nga një familje e dëshmoreve nuk kish dashtë me i përkrah raste të tilla sidomos kur bëhet fjalë më i paraqit masakrat e Drenasit apo Drenicës në vendet tjera me e shiku se çfarë gjenocidi është bërë tek ne. Realisht unë kam kthyer përgjigje negative për arsyeje sepse nuk kemi pas mundësi financiare sepse planifikimin e buxhetit e bëjmë paraprakisht të vitit fiskal për vitin 2022 në këtë rast nuk kemi pas mundësi dhe arsyeja tjetër është se ne e kemi një rregullore në bazë të cilës ne i ndajmë subvencionet dhe unë veproj në përputhje me atë rregullore. Arsyeja tjetër është se në fillim të shkurtit kur është bërë kërkesa ne e kemi pas zero buxhet për arsyeje se nuk është alokuar buxheti, për kundër vullnetit dhe dëshirës me e mbështet nuk kemi pas mundësi financiare me e përkrah. Organizata "For New Live Kosovo" nuk është e regjistruar si OJQ e Drenasit, ne përmes rregullores kemi të drejtë me i mbështet vetëm OJQ-të e Drenasit.

Hamit Haxhiu- kërkoj përgjigje nga kryetar i komunës për:

“Kërkesën e bërë nga bashkësia islame” dega në Drenas.

Në bazë të kërkesave të banorëve, bashkësia islame ka kërku nga kryetari që të ndahet parcela me numër 1296-0, (e cila është në zonën kadastrale), për ndërtimin e Xhamisë në Llapushnikë (lagjeja Poterrk).

Në mungesë të kryetarit dhe nënkryetarit të komunës në mbledhje të KPF, përgjigja e kërkesës mbetet për në seancën e kuvendit komunal.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, meqë nuk pati diskutime te tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur takimin.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 11:30 min.

Procesmbajtëse:



Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Milaim Hajdari



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
KOMUNA E DRENASIT



Zyra e Kryetarit
Nr.01 462/02 15941 . dt. 13.04 2022

Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72.2 paragrafi (a) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 53 paragrafi 1 dhe nenit 57 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, Kuvendi i Komunës së Drenasit/Gllogocit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2022 të miraton këtë:

PROPOZIM – VENDIM
PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT 12 NR. 462/01-47368 TË DATËS 30.10.2020, TË
KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT

I

Propozohet shfuqizimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës së Drenasit/Gllogocit 12 Nr. 462/01-47368 të datës 30.10.2020 për këmbimin e njërive të ndërtesave (banesave) në parcelën nr. 743-1, në zonën Kadastrale në Gllogoc.

II

Bazë për shfuqizimin e këtij vendimi është neni 53 paragrafi 1 dhe neni 57 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031.

III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

IV

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të MPL-së, si dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.


KRYETARI I KOMUNËS

Ramiz Lladrovci

A r s y e t i m

Kuvendi i Komunës së Drenasit me qellim të realizimit të interesit publik me datë 30.10.2020 ka nxjerr Vendimin Nr.12-462/01-47368 për këmbimin e njësive të ndërtesave në parcelën nr. 743-1 në zonën kadastrale në Gllogoc.

Banoret në atë pjesë kanë objekte të vogla banimi të ndërtuara në vitet e 60-70 ta, në pronën komunale, e për të cilat nga vlerësimi i Zyrës për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme shihet që është i pamundur këmbimi me objektet pronë komunale, të cilat janë nderuat në vitin 2014.

Andaj, në pamundësi të realizimit të vendimit të Kuvendit të Komunës së Drenasit Nr.12 462/01-47368 të datës 30.10.2020 për këmbimin e njësive të ndërtesave (banesave) në parcelën nr. 743-1, në zonën Kadastrale në Gllogoc, është e nevojshme të bëhet shfuqizimi i këtij vendimi, që të mundësohet vazhdimi me procedurat e tjera konform ligjeve në fuqi.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
KUVENDI KOMUNAL



12 Nr. 462/01-47368 dt. 30.10 2020

Bazuar në nenin 11, 12, paragrafi 1, paragrafi 2, nenit 14 paragrafi 1 dhe 40, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34, pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 24 dhe 25 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë **30.10.2020**, miraton këtë:

V E N D I M

Për Këmbimin e Pronave të Paluajtshme (Njësive të ndërtesave - Banesave) në parcelën nr. 743-1, në zonën Kadastrale në Glllogoc

Neni 1

Vendimi për këmbimin e pronave të paluajtshme (njësive të ndërtesave – banesave, të cilat u janë dhënë pronarëve në shfrytëzim të përherëshëm nga Komuna e Glllogocit), në parcelën nr.743-1 në zonën kadastrale në Glllogoc.

Neni 2

Këmbimi i këtyre pronave të paluajtshme ka për qëllim realizimin e interesit publik të Komunës së Drenasit konkretisht për realizimin e projektit të Planit Urbanistik, Hapsinor dhe Zhvillimor Komunal - 2020-2028.

Neni 3

Pronat e paluajtshme (njësitë e ndërtesave - Banesat), të cilat do të këmbehen kanë këto karakteristika:

- 1- Njësia e ndërtesës nr.70315016-24-1-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues (bashkëposesues) Drita (Muhamet) Baleci Glllogoc 3/5, Jeton (Muhamet) Hoxha Glllogoc 2/5.
- 2- Njësia e ndërtesës nr.00743-1-23-1-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Ruzhdi (Haki) Hoxha Glllogoc.
- 3- Njësia e ndërtesës nr.70315016-23-2-1-0 me sipërfaqe prej 59.28m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Afrim (Ujkan) Hysenaj Glllogoc.
- 4- Njësia e ndërtesës nr.70315016-21-2-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Gani (Ilaz) Hoxha Glllogoc.

- 5- Njësia e ndërtesës nr.00743-1-20-1-0 me sipërfaqe prej 61m^2 , zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Xhyla (Ramadan) Halilaj Glllogoc.
- 6- Njësia e ndërtesës nr.70315016-21-1-1-0 me sipërfaqe prej 61m^2 , zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Murtez (Rizah) Zogu Glllogoc.
- 7- Njësia e ndërtesës nr.70315016-24-2-1-0 me sipërfaqe prej 61m^2 , zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Arsim (Hasan) Gashi Glllogoc.
- 8- Njësia e ndërtesës nr.70315016-26-1-1-0 me sipërfaqe prej 61m^2 , zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Fadil (Jahir) Haxhiu.
- 9- Njësia e ndërtesës nr.70315016-27-3-1-0 me sipërfaqe prej 61m^2 , zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Musli (Myrtë) Haxhiu Glllogoc.
- 10- Njësia e ndërtesës nr.00743-1-20-1-1-0 me sipërfaqe prej 61m^2 , zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Shpetim (Idriz) Morina 1/2 dhe Shkumbin (Idriz) Morina 1/2.

Neni 4

Njësitë e ndërtesave (banesat) të cilat i posedon komuna dhe që mund të këmbehen janë si në vijim:

00743-1-18-2-7-0, me sipërfaqe prej	$S=84\text{m}^2$
00743-1-18-2-22-0, me sipërfaqe prej	$S=65\text{m}^2$
00743-1-18-2-17-0, me sipërfaqe prej	$S=63\text{m}^2$
00743-1-18-2-39-0, me sipërfaqe prej	$S=84\text{m}^2$
00743-1-18-2-34-0, me sipërfaqe prej	$S=64\text{m}^2$
00743-1-18-2-40-0, me sipërfaqe prej	$S=56\text{m}^2$
00743-19-3-13-0, me sipërfaqe prej	$S=68.22\text{m}^2$
00743-19-3-29-0, me sipërfaqe prej	$S=68.22\text{m}^2$
00743-19-3-28-0, me sipërfaqe prej	$S=91.48\text{m}^2$
00743-19-3-39-0, me sipërfaqe prej	$S=52.66\text{m}^2$
00743-19-3-38-0, me sipërfaqe prej	$S=102.81\text{m}^2$
00743-19-3-37-0, me sipërfaqe prej	$S=68.22\text{m}^2$
00743-19-3-36-0, me sipërfaqe prej	$S=91.48\text{m}^2$
00743-19-3-48-0, me sipërfaqe prej	$S=52.66\text{m}^2$
00743-19-3-47-0, me sipërfaqe prej	$S=102.81\text{m}^2$
00743-19-3-46-0, me sipërfaqe prej	$S=68.22\text{m}^2$
00743-19-3-45-0, me sipërfaqe prej	$S=91.46\text{m}^2$

Neni 5

Mënyra dhe kushtet e këmbimit të këtyre pronave të paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe me pronarët e pronave të paluajtshme (të banesave që iu janë dhënë në shfrytëzim të përherëshëm nga komuna, në zonën kadastrale në Glllogoc, në parcelën nr.743-1), pas kthimit të vlerësimit të këtyre pronave nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme.

Neni 6

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që të përfundoj të gjitha procedurat e nevojshme gjeodezike, kadastrale që nevojiten për këmbimin e këtyre objekteve.

Neni 7

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e Komunës së Drenasit.

Neni 8

Me këtë Vendim do të njoftohen organet kompetente të Komunës së Drenasit.

Neni 9.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit .



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Hallaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
KOMUNA E DRENASIT
Zyra e Kryetarit



Nr. 01-464/01-15943 ,dt. 13/04/ .2022

Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72.2 paragrafi (a) të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 paragrafi 1 dhe paragrafi 2, nenit 14 pika 1, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenit 4, 7 dhe 8 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Ligji nr.03/L-139, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, si dhe në bazë të Vendimit të Kuvendit 12 Nr.462/01-47383 dt, 30.10.2020 dhe ligjshmërisë së këtij Vendimi nga MPL nr. VI 020-828/8 dt, 16.11.2020, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2022 të miraton këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për Shpronësimin e njësive të ndërtesave- banesave, në parcelën nr.743-30, në zonën kadastrale në Glllogoc.

I.

Të MIRATOHET propozim-vendimi i Kryetarit të Komunës për Shpronësimin e Njësive të Ndërtesave - Banesave të cilat janë të ndërtuara në parcelën nr.743-30, në zonën kadastrale në Glllogoc.

II.

Shpronësimi i këtyre pronave ka për qëllim realizimin e interesit publik të Komunës së Drenasit konkretisht realizimin e Planit Zhvillimor Komunal 2020-2028.

III.

Njësitë e Ndërtesave - Banesave që do të shpronësohen kanë këto karakteristika:

- 1- Njësia e ndërtesës nr.O-70315016-24-1-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues (bashkëposesues) Drita (Muhamet) Baleci Glllogoc 3/5, Jeton (Muhamet) Hoxha Glllogoc 2/5.
- 2- Njësia e ndërtesës nr.O-70315016-00743-1-23-1-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Ruzhdi (Haki) Hoxha Glllogoc.
- 3- Njësia e ndërtesës nr.O-70315016-23-2-1-0 me sipërfaqe prej 59.28m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Afrim (Ujkan) Hysenaj Glllogoc.
- 4- Njësia e ndërtesës nr.O-70315016-21-2-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Gani (Ilaz) Hoxha Glllogoc.
- 5- Njësia e ndërtesës nr.O-70315016-00743-1-20-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Xhyla (Ramadan) Halilaj Glllogoc.
- 6- Njësia e ndërtesës nr.O-70315016-21-1-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Murtez (Rizah) Zogu Glllogoc.

- 7- Njësia e ndërtesës nr.O-70315016-24-2-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Arsim (Hasan) Gashi Glllogoc.
- 8- Njësia e ndërtesës nr.O-70315016-26-1-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Fadil (Jahir) Haxhiu.
- 9- Njësia e ndërtesës nr.O-70315016-27-3-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Musli (Myrtë) Haxhiu Glllogoc.
- 10- Njësia e ndërtesës nr.O-70315016-00743-1-20-1-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Shpetim (Idriz) Morina 1/2 dhe Shkumbin (Idriz) Morina 1/2.
- 11- Njësia e ndërtesës nr.O-70315016-22-1-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Hysri (Rama) Morina.

IV

Vlera e kompensimit për banesat që do të shpronësohen do të caktohet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave në pajtim me Ligjin Nr.03/L-139 për Shpronësimin e pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010 dhe Udhëzimit Administrativ nr.02/2015 për miratimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.

V

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit i cili do të inicon procedurën e mëtejme për shpronësim të objekteve banesore të cilat ndodhen në zonën kadastrale në Glllogoc.

VI

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, që të përfundoj të gjitha procedurat e nevojshme gjeodezike, kadastrale që nevojiten për shpronësimin e këtyre njësive të ndërtesave-banesave.

VII

Me këtë Vendim do të njoftohen organet kompetente të Komunës së Drenasit/Glllogocit.

VIII.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe publikimit në ueb-faqen e Komunës.


KRYETARI I KOMUNES
Kamiz Lladrovci

A r s y e t i m

Baza juridike për ta propozuar dhe miratuar këtë Vendim është e përcaktuar me dispozitat e nenit 12 paragrafi 1 dhe paragrafi 2, nenit 14 pika 1, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenit 4, 7 dhe 8 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Ligji nr.03/L-139, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205, si dhe në bazë të Vendimit të Kuvendit 12 Nr.462/01-47383 dt, 30.10.2020 për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të pronave të Paluajtshme (njësive të ndërtesave – banesave) dhe ligjshmërisë së këtij Vendimi nga MPL nr. VI 020-828/8 dt, 16.11.2020.

Po ashtu Kuvendi i Komunës së Drenasit me datë 30.07.2020, ka miratuar Vendimin për Miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2020-2028, ku ky plan parasheh që në këtë pjesë do të do të ketë hapësirë për rekreacion, gjelbërim, si dhe do të bëhen ndërtime të larta, prandaj për realizimin e këtij plani zhvillimor është e domosdoshme që të bëhet shpronësimi i këtyre pronave të paluajtshme.

Ky shpronësim, në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë është i domosdoshëm për arritjen e qëllimit të cekur më lartë.

Ky qëllim nuk mund të arrihet në mënyrë praktike pa kryerjen e shpronësimit të këtyre banesave.

Të bashkangjitur keni skicat, kopjet e planit dhe fletatposeduese të njësive të ndërtesave/banesave.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GLLOGOC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Gllogoc

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-70315016-00743-30	Parcelë / Parcela / Parcel	8510
O-70315016-00743-1-24-0	Ndërtesë / Zgrada / Building	151
O-70315016-00743-1-26-0	Ndërtesë / Zgrada / Building	151
O-70315016-00743-1-22-0	Ndërtesë / Zgrada / Building	152
O-70315016-00743-1-25-0	Ndërtesë / Zgrada / Building	162
O-70315016-00743-1-27-0	Ndërtesë / Zgrada / Building	151
O-70315016-00743-1-20-0	Ndërtesë / Zgrada / Building	151
O-70315016-00743-1-23-0	Ndërtesë / Zgrada / Building	149
O-70315016-00743-1-21-0	Ndërtesë / Zgrada / Building	161

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 06.04.2022

Koha/ Vreme/ Time: 03:35:14

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoui/Usvojio/Approved:  Direktor/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GLLOGOC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Gllgoc



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1151

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 06.04.2022

Koha/ Vreme/ Time: 03:35:14

Nënshkrimi/Potpis/Signature:


Shënim/Beleška/Note:

Aprovoui/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



Skica e situacionit për parcelën 743-30 në pronësi të komunës së Drenasit





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GLLOGOC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Gllogoc

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-70315016-00743-30	Parcelë / Parcela / Parcel	8510
O-70315016-00743-1-24-0	Ndërtesë / Zgrada / Building	151
O-70315016-00743-1-26-0	Ndërtesë / Zgrada / Building	151
O-70315016-00743-1-22-0	Ndërtesë / Zgrada / Building	152
O-70315016-00743-1-25-0	Ndërtesë / Zgrada / Building	162
O-70315016-00743-1-27-0	Ndërtesë / Zgrada / Building	151
O-70315016-00743-1-20-0	Ndërtesë / Zgrada / Building	151
O-70315016-00743-1-23-0	Ndërtesë / Zgrada / Building	149
O-70315016-00743-1-21-0	Ndërtesë / Zgrada / Building	161

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 06.04.2022

Koha/ Vreme/ Time: 03:35:14

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoui/Usvojio/Approved: Drastori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA


MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GLLOGOC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Glogoc



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1151

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 06.04.2022

Koha/ Vreme/ Time: 03:35:14

Nënshkrimi/Potpis/Signature:


Shënim/Beleška/Note:


Aprovoi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature



Skica e situacionit për parcelën 743-30 në pronësi të komunës së Drenasit





Republika e Kosovës


Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Pushtetit Lokal

Ministarstvo Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government



Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Goran Rakić, Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MPL-së	
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 09.11.2020 Nr.020-828
Zyrtaret përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit	
Lloji i aktit:	☐ Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim i Kuvendit të Komunës 12 Nr. 462/01-47383 për shpalljen e interesit të përgjithshëm të pronave të paluajtshme (njësive të ndërtesave - Banesave), në parcelën nr. 743-1, në zonën kadastrale në Glllogoc

I miratuar më datë: 30.10.2020

I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 30.10.2020

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
KUVENDI I KOMUNËS



Nr. 462/C1- 157.053, dt. 30.10.2020

Bazuar në nenin 11.12 dhe 40.15 Ligjit nr.03 L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 34, pikë 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, në bazë të nenit 12 paragrafi 1 dhe paragrafi 2, 14 pikë 1 të Ligjit Nr.03 L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.10.2020, miraton këtë:

V E N D I M

Për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të pronave të paluajtshme (njësive të ndërtësive – Banesave), në parcelën nr.743-1, në zonën kadastrale në Gillogoc.

Neni 1

Vendimi për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik, të Pronave të paluajtshme (njësive të ndërtësive – banesave të cilat u janë dhënë pronatëve në shifra tëzime të përhershme nga Komuna e Drenasit, të ndërtuara në pronën komonale), në parcelën nr.743-1, në zonën kadastrale në Gillogoc.

Neni 2

Shpallja e interesit të përgjithshëm publik të këtyre njësive të ndërtësive ka për qëllim realizimin e interesit publik të Komunës së Drenasit konkretisht për realizimin e Planit Urbanistik, Hapësiror dhe Zvillimor Komunal- 2020-2028.

Neni 3

Pronat e paluajtshme që do të shpallen interes i përgjithshëm publik kanë këto karakteristika:

- 1- Njësia e ndërtësës nr.70315016-27-1-1-0, me sipërfaqe prej 33m², zona kadastrale Gillogoc, me shfrytëzues Agim (Ujkan) Hysenaj nga Abria e Ipërme.
- 2- Njësia e ndërtësës nr.70315016-22-2-1-0, me sipërfaqe prej 30m², zona kadastrale Gillogoc, me shfrytëzues Elver (Sheqiri) Istogu nga Pölluzha.
- 3- Njësia e ndërtësës nr.70315016-27-2-1-0, me sipërfaqe prej 32.8m², zona kadastrale Gillogoc, me shfrytëzues Arbora (Murat) Veliu nga Korrutica e Poshtme.
- 4- Njësia e ndërtësës nr.70315016-00743-1-22-3-1-0, me sipërfaqe prej 35m², zona kadastrale Gillogoc, me shfrytëzues Nexir (Sherif) Prokshi nga Qikatova e Re.
- 5- Njësia e ndërtësës nr.70315016-26-2-1-0, me sipërfaqe prej 33m², zona kadastrale Gillogoc, me shfrytëzues Liridon (Halil) Maxhuni 1 2 dhe Armand (Halil) Maxhuni 1 2.
- 6- Njësia e ndërtësës nr.70315016-25-1-1-0, me sipërfaqe prej 33m², zona kadastrale Gillogoc, me shfrytëzues Tahir (Ukë) Leka Gillogoc.
- 7- Njësia e ndërtësës nr.70315016-1-26-3-1-0, me sipërfaqe prej 33m², zona kadastrale Gillogoc, me shfrytëzues Xhater Musli Halil Gillogoc.

- 8- Njësia e ndërtesës nr.70315016-24-1-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues (bashkëposesues) Drim (Muhamet) Balceri Glllogoc 3.5, Jeter (Muhamet) Hoxha Glllogoc 2.5.
- 9- Njësia e ndërtesës nr.00743-1-23-1-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Rushdi (Haki) Hoxha Glllogoc.
- 10- Njësia e ndërtesës nr.70315016-23-2-1-0 me sipërfaqe prej 59.28m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Afrim (Ujkan) Hysenaj Glllogoc.
- 11- Njësia e ndërtesës nr.70315016-21-2-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Gani (Ilaz) Hoxha Glllogoc.
- 12- Njësia e ndërtesës nr.00743-1-20-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Xhyla (Ramadan) Halilaj Glllogoc.
- 13- Njësia e ndërtesës nr.70315016-21-1-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Murtez (Rizab) Zogu Glllogoc.
- 14- Njësia e ndërtesës nr.70315016-24-2-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Arsim (Hasan) Gashi Glllogoc.
- 15- Njësia e ndërtesës nr.70315016-26-1-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Fadri (Jahir) Haxhiu.
- 16- Njësia e ndërtesës nr.70315016-27-3-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Mushi (Myrtë) Haxhiu Glllogoc.
- 17- Njësia e ndërtesës nr.00743-1-20-1-1-0 me sipërfaqe prej 61m², zona kadastrale Glllogoc, me shfrytëzues Shpetim (Idriz) Morina 1.2 dhe Shkumbin (Idriz) Morina 1.2.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi përkuqdeset Kryetari i Komunës që konton dispozitave ligjore në fuqi të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme.

Neni 5

Me këtë Vendim do të njoftohen organet kompetente të Komunës së Drenasit Glllogocit.

Neni 6

Ky Vendim hyjë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPP-ja dhe të cilat janë të detyrueshme për të gjithë qytetarët të Komunës.

Vendimi dërgohet:

- Zyres së kryetarit;
- Drejtorsë Përkrahëse;
- Zyres së Kuvendit;
- Arkivit.



Kuvendi i Komunës

not Halilaj



Republika e Kosovës
Komuna e Glogocit
Kuvendi i Komunës



12 Nr 400/01-28767 dt. 30.07 2020

Bazuar në nenin 11,12, dhe 40, të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, nenit 34,pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 10 paragrafi 2 nen paragrafi 2.2 , të Ligjit Nr.04/L-174, për Planifikimin Hapësinor, Vendimit Nr.632 për dhënien e Pëlqimit për Miratim të Planit Zhvillimor Komunal të Glogocit 2020-2028, nga Departamenti për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, të inicuar dhe hartuar nga Komuna e Glogocit. Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 30. 07.2020, miratoj këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË GLLOGOCIT 2020-2028

Neni 1

Kuvendi i Komunës së Glogocit të miratoj propozim vendimin për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal të Glogocit për periudhën 2020-2028.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani Zhvillimor Komunal i Glogocit për periudhën, 2020-2028.

Neni 3

Plani Zhvillimor Komunal i Glogocit 2020-2028, është hartuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit në koordinim me drejtoritë sektoriale dhe burimet njerëzore brenda Komunës.

Neni 4

Për zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal të Glogocit për periudhën 2020-2028, përgjegjëse është Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Glogocit.

Neni 5

Dokumenti i planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij propozim vendimi duhet të jetë në gjuhë zyrtare dhe së paku në 3 (kopje) të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15,ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pasë publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit
- Drejtorisë Përkatëse
- Zyrës së Kuvendit
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Halilaj







Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

PERSONI / OSOBA / PERSON : ZOGU MURTEZ

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	07-942-30/03/2022
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	31.03.2022 - 08:29
Komuna / Opština / Municipality:	GLLOGOC / GLOGOVAC / GLLOGOC
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	GLLOGOC / GLOGOVAC / GLLOGOC

A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

Mbiemri/Emri i afarizmit (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name	Emri Ime First Name	Emri i babait Ime oca Father's Name	Gjinia Pol Gender	Nr. personal/ biznesit Lieni broj/broj poslovanja ID. No.	Shteti i shtetësisë apo regjistrimit Država državljanstva ili uknjiženja Country of citizenship	Ditëlindja/Data e themelimit Rodendan/Dan osnivanja Date of Birth/Establishment	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
ZOGU	MURTEZ	RIZAH	Mashkull / Musko / Male	1015707522	KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO	15.05.1945		10.10.2013

A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address Details	Azhuruar Ažurirano Updated
Kodra e Diellit / Kodra e Diellit / Kodra e Diellit		ZONA LINDORE 15	10.10.2013

B. NJESIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT

Njesia kadastrale Katastarska jedinica Cadastral unit	Komuna / Opština / Municipality	Zona kadastrale Katastarska zona Cadastral zone	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit type	Tipi i pronës Tip imovine Property Type / Lloji i pronës Vrsta imovine Property kind	Kati/ Katet Br.Sprat a/ Spratova Floor number	Vendi i quajtur Zvano mesto Place name	Sipërfaqja Površina Area	Shfrytëzimi aktual/Kultura- klasa Aktuelna upotreba/ Kultura-klasa Actual use/Culture-class	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right	Azhuruar Azurirano Updated
O-70315016-21-1-1-0	GLLOGOC / GLOGOVAC / GLLOGOC	Glogoc / Glogovac / Glogoc	PJESA e NDËRTESESË / DELOVA ZGRADA / part of building	Shoqërore Društvena Socially / U	P	GLLOGOC / GLOGOVAC / GLLOGOC	61	Bancë / Stan / Apartment /	1 / 1	Pronësi individuale (Një Pronarë) / Individualno Vlasništvo (1 V1) / Single Owner	10.10.2013





Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GLLOGOVC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Glllogoc

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi / vrsta / Type	Sipërfaqja/Povrsina/Area
O-70315016-21-1-1-0	banesë	61



O-70315016-21-1-1-0

Shkalla/Razmera/Scale : 500

Punoi/ Obradio/ Created:

Data/ Data/ Date: 04.04.2021

